



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 445, datë 01.11.2022

PËR

NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQITARIT TË GJYKATËS SË POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR TË Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 01.11.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për ngritjen në detyrë e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar të z. {...}”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Klodian Kurushi,

V Ë R E N:

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji¹, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës),

¹- Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; i ndryshuar; Vendimi nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”; - Vendimi nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”; - Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”; - Vendimi nr.264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; - Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë, ndër të tjera, edhe për 3 (tre) pozicionet e lira, respektivisht me Vendimin nr. 117, Vendimin nr.118 dhe Vendimin nr.119, datë 01.04.2021.

2. Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.119, datë 01.04.2021 brenda afateve të kandidimit, që përfundojë respektivisht në datën 16.04.2021 kandiduan gjithsej 2 (dy) kandidatë dhe konkretisht: znj. Tereza Merkaç dhe z. {...}.
3. Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve *që përmbushin kriteret*, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.
4. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme:
 - i) **“përvojës profesionale minimale”**, sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “2. *Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale: ...; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; ...*”;
 - ii) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “8. *Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”;
 - iii) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “1. *Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë,*

paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklarohet nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;

- iv) ***“dhënies së pëlqimit (ai/a jo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, sipas pikës 4, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “4. ... Kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, ..., si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit”; pikës 3, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; si dhe pikave 1 dhe 2, të nenit 48, të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku përcaktohet se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ... firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetë private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të dhënë në shtojcat B1 e B2 të këtij ligji. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. 2. Anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në pikën 1 gjithashtu firmosin deklaratën përkatëse për heqjen dorë nga të drejtat, të dhënë në shtojcën B3 të këtij ligji, si tregues se i kuptojnë kushtet”;***
- v) ***të pasurisë dhe figurës,*** sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*
5. Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit për katër kriteret formale të kandidimit, pikërisht atyre të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe të “dhënies së pëlqimit (ai/a jo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e

institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

6. Për të dy kandidatët, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar. Konkretisht:
 1. *Për znj. Tereza Merkaj*, Këshilli ka vendosur kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë, me Vendimin nr. 228, datë 02.06.2021;
 2. *Për z. {...}*, Këshilli ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë, me Vendimin nr. 355, datë 09.09.2021;
7. Siç u parashtua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) *vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019*, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019.
8. Ndërsa proceset e verifikimit të kriterëve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 394, datë 22.09.2021, filloi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, ndër të tjera, edhe të atyre që kanë kandiduar për pozicionin e lirë si më lart, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me këtë vendim, si relator i procedurave të përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Ilir Toska. Pas përfundimit të mandatit të Z. Ilir Toska si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.27, datë 17.01.2022 u caktua si relator i procedurave të përzgjedhjes z. Klodian Kurushi.
9. Më datë 18.01.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundështime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

10. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), relatori administroi dokumentacionin përkatës të secilit kandidat, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësisht të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për ata.
 - 10.1 Për kandidaten znj. Tereza Merkaj u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 240, datë 30.06.2022 dhe nr. 257, datë 15.07.2022, vendime të cilët janë përfundimtarë, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar shkresës datë 09.09.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.
 - 10.2 Për kandidatin z. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 553, datë 01.12.2021 dhe nr. 554, datë 01.12.2021, vendime të cilët janë përfundimtarë pasi, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar shkresës datë 09.09.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit.
11. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (*Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve*), të Vendimit 70/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me vendimin nr.119, datë 01.04.2021 të Këshillit.
12. Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajt në konsideratë pika 9, e Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “9. *Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor; b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist”. Gjithashtu, u mbajtën në konsideratë edhe hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 70/2020, dalë në zbatim të pikës 14, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “14. *Këshillat miratojnë rregulla më të**

detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta; ...”.

13. Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit 70/2020. Në këtë hap nuk arrihet të identifkohet kandidati me rezultatet më të larta, pasi rezultoi që kandidatja znj. Tereza Merkaj dhe kandidati z. {...}, të kenë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Në hapin tjetër referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “*përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit*”, u konstatua se njëri nga dy kandidatët me rezultate nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, ka përvojë të tillë, e konkretisht z.{...}. Ky i fundit nga viti 2016 - vitin 2020 ka qenë i komanduar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë². Pas përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit z. {...} është caktuar në skemën e delegimit prej nëntorit 2020 dhe ricaktuar sërish në nëntor të vitit 2021. Nga ana tjetër znj. Tereza Merkaj me vendimin nr.225, datë 22.10.2019 të KLGj është komanduar në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat 5 (pesë) vjeçar. Afati i komandimit fillon më datë 15 nëntor 2019, pra siç rezulton nuk ka përfunduar afati i komandimit.
14. Mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes, mbështetur në nenet 135, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 10 dhe 14, të nenit 48, në pikën 3 të nenit 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin 70/2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 377, datë 19.09.2022, vendosi:

“1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1. Z. {...};*
- 2. Znj. Tereza Merkaj.”*

15. Vendimi sipas pikës 14, të këtij relacioni, më datë 11.10.2022, iu njoftuan rregullisht kandidatëve z. {...} dhe znj. Tereza Merkaj, të cilët, bazuar në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

² KLD me vendimin nr. 104, datë 04.11.2016, ka vendosur komandimin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, {...}, si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe KLGj me vendimin nr.227, datë 22.10.2019 ka zgjatur mandatin e komandimit edhe me 1(një) vit.

16. Kandidatja znj. Tereza Merkaj, nuk rezulton të ketë ushtruar ankim ndaj këtij vendimi brenda afatit ligjor, siç konfirmohet nga shkresa kthim përgjigje datë 18.10.2022 e Gjykatës Administrative të Apelit. Ndërsa kandidati {...} {...} në rrugë elektronike konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin si më lart të Këshillit. Po ashtu, ky kandidat, i bëri të ditur Këshillit të Lartë Gjyqësor se nuk ka ankim ndaj vendimit dhe se i kërkonte atij të procedonte për ngritjen e tij në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këto kushte ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.
17. Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 68, të Vendimit 70/2020, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 119, datë 01.04.2021 të kandidatit z. {...}.

II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

18. Projektvendimi “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. {...}”, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Kreu VIII, të Vendimit 70/2020.

19. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar në funksion të procedurës së renditjes.

KONKLUZIONI

20. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. {...}”.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 119, datë 01.04.2021, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

V E N D O S I:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të z. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 06.11.2022.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykatës së Apelit Durrës, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR